

VENDIM
Nr. 443, datë 22.5.2017

**PËR BASHKËFINANCIMIN E SHITESËS SË KONTRATËS “PËR NDËRTIMIN E VIJËS
BREGDETARE TË VLORËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, si dhe në vijim të vendimit nr. 71, datë 12.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, përfaqësuar nga Komisioni Evropian, për programin kombëtar për Shqipërinë, në kuadrin e komponentit IPA “Asistenca e Tranzicionit dhe Mbështetja Institucionale”, për vitin 2013, nënshkruar nga Koordinatori Kombëtar i fondeve IPA në datën 19.2.2014, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi, në vlerën 318 550 000 (treqind e tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, nga zëri “Kosto lokale”, i miratuar në buxhetin e vitit 2017 për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, të përdoret për bashkëfinancimin e shtesës së kontratës së punimeve, me nr. 2015/360-660, datë 13.5.2015, “Për ndërtimin e vijës bregdetare të Vlorës”, të bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, me përfitues Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

2. Pagesat për shtesën e kontratës së punimeve do të bëhen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në bazë të kërkesës së Delegacionit të Bashkimit Evropian.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi